

4. MASAT ADMINISTRATIVE

Për shkeljet e të drejtave të pronësisë industriale:

Çdo veprim i kryer në shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.

Në rast përsëritjeje, dënimi maksimal i parashikuar dyfishohet. Përsëritje vlerësohet rasti kur shkelësi e kryen shkeljen për herë të dytë brenda një periudhe prej pesë vjetësh.

Për shkeljet e të drejtave të autorit:

Personi përgjegjës i personit juridik (administratori) ose personi fizik dënohet për kundërvajtjet e parashikuara në ligj, me gjobë në shumën prej 100 000 deri në 500 000 lekësh nëse përdor një veprë të autorit apo mbajtësit të së drejtës pa autorizimin e tij.

5. BAZA LIGJORE

ISHMT ushtron veprimtarinë në përputhje me:

- Ligjin 10433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",
- Ligj 36/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to",
- Ligj 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.



Për Informacion të mëtejshëm drejtohuni pranë ISHMT:

Adresa: – Tiranë , Rruga "Shyqyri Bërxolli", Nr.65 nga ora 08:00 deri më 16:30, (të premtën 08:00 deri më 14:00)

E-mail: info@ishmt.gov.al

Website: www.ishmt.gov.al

Facebook: "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut"

Twitter: @ISHMT



BROSHURË INFORMUESE MBROJTJA E TË DREJTAVË TË PRONËSISË INTELEKTUALE NË TREGUN E BRENDSHËM

1. ÇFARË DUHET TË DINI PËR PRONËSINË INTELEKTUALE?

Pronësia intelektuale përbëhet nga dy degë:

1. Pronësia industriale mbron dhe rregullon pronësinë dhe të drejtat për t'i përdorur dhe shfrytëzuar ekonomikisht objektet si më poshtë:

- markat tregtare;
- Disenjot industriale;
- Treguesit gjeografikë ose emërtimet origjinës;
- Patentat për shpikje;

"Pronar" i një objekti të pronësisë industriale është personi fizik ose juridik që ka një certifikatë regjistrimi në Republikën e Shqipërisë për objektet e mësipërme:

"Mbajtës i së drejtës", nënkupton titullarin e një të drejte të pronësisë industriale të bazuar në një kontratë liçence të regjistruar ose një autorizim për përdorim të lëshuar nga pronari i një objekti të pronësisë industriale.

• **Pronësia mbi objektet e pronësisë industriale fitohet vetëm nëpërmjet regjistrimit të tyre pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.**

Publikimi u mundësua nga projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale, një projekt i Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) i zbatuar nga Zyra Federale Zvicerane për Pronësinë Intelektuale.



IGE | IPI



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

2. E drejta e autorit mbron të drejtat e krijuesve mbi krijimet e tyre letrare, artistike dhe shkencore si më poshtë:

- krijimet hartografike, tredimensionale, dhe të arteve të aplikuara
- krijimet e fjalës dhe programet kompjuterike;
- krijimet audiovizuale
- krijimet e artit pamor
- krijimet shkencore
- krijimet fotografike
- krijimet arkitekturore

“Autor” është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.

Të drejtat e mbrojtura janë:

- Të drejtat ekonomike lejojnë mbajtësin e të drejtave të përfitojë shpërblime financiare nga përdorimi i veprës së tij nga të tjerët.
- Të drejtat morale lejojnë të autorit ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga të drejtat pasurore dhe siguruar respektin ndaj cilësive të tij intelektuale dhe personale në punë.
- Të drejtat vetjake jopasurore të autorëve mbrohen pa asnjë kufi kohor. Pas vdekjes së autorit, mbrojtja e këtyre të drejtave merret përsipër nga trashëgimtarët ligjorë.
- Të drejtat pasurore, mbrohen gjatë gjithë jetës së autorit dhe deri në 70 vjet pas vdekjes së tij, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligj.

• E drejta e autorit nuk ka nevojë për rregjistrime apo të tjera formalitete. E drejta e autorit mbi një vepër lind automatikisht në momentin e krijimit të veprës origjinale ose të prejardhur.

Mbajtësit e të drejtave të pronësisë intelektuale gëzojnë të drejtën të drejtën ekskluzive të përdorimit, kopjimit apo imitimit të këtyre objekteve dhe të ndalojnë palët e treta të përdorin ato për qëllime tregtare, pa autorizimin e tyre.
Për të mbrojtur këto të drejta ata mund të drejtohen pranë ISHMT.

2. INSPEKTORIATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT (ISHMT)

ISHMT është institucioni që bën të mundur respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse.

Në përmbushje të kërkesave ligjore në këtë fushë pranë ISHMT është krijuar Drejtoria e Pronësisë Intelektuale, e ndarë në dy sektorë:

• Sektori i Pronësisë Industriale kryen inspektime në bazë të:

- Ankesave të ardhura nga pronarët ose mbajtësit e së drejtës.
- Ndërhyn ex officio, për rastet e dyshuara të cënimit të titujve të pronësisë industriale dhe falsifikimit të produkteve.

ISHMT në bazë të ankesave të ardhura është i detyruar të bëjë verifikimet përkatëse dhe, në bazë të përfundimeve të nxjerra, mund të vendosë masa administrative, përveç kur tregtari vërteton, nëpërmjet dokumenteve të origjinës së mallrave, se ato nuk janë të falsifikuara.

ISHMT i ndërpret masat e marra, nëse pronarët ose mbajtësit e të drejtave, të një patente, disenoje ose marke të regjistruar apo përdoruesit e autorizuar të treguesit gjeografik të regjistruar, nuk ngrenë padi në gjykatë për shkeljen e të drejtave të tyre brenda 20 ditëve (ditë pune) nga data e njoftimit të marrjes së masave.

- Sektori i së Drejtës së Autorit kryen inspektime në bazë të:
 - Programimeve mujore dhe vjetore.
 - Ankesave nga autorët apo mbajtësit e së drejtës.Kategoritë e inspektimit të ISHMT për të drejtat e autorit janë:

- **Kategoria e librit;** (Shtëpi botuese, shtypshkronjë, librari, fotokopje, bibliotekë, etj.)

- **Kategoria e veprave audiovizuale dhe kompozimet muzikore** (Televizione, radio, kabllor, hotele, bar-resorante, pub, resorte etj.)

- **Kategoria e programeve kompjuterike** (Shërbime telefonike (call center), universitete, shkolla, kompani të ndryshme etj.)

3. KRITERET LIGJORE GJATË PROCESIT TË INSPEKTIMIT

Thelbi i shkeljes së të drejtave mbi pronësinë intelektuale, sipas rastit, është përdorimi i objekteve të pronësisë intelektuale për qëllime tregtare pa autorizimin e pronarëve ose mbajtësve të të drejtave. Për këtë arsye gjatë aktivitetit të tyre tregtar subjektet tregtare duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar origjinën tregtare të produkteve që ata kanë në përdorim.

1. Të drejtat e subjekteve të inspektimit:

- a) të kërkojnë të njihen me autorizimin dhe procesverbalin e inspektimit;
- b) të kërkojnë identifikimin e inspektorëve nëpërmjet kartës së inspektorit;
- c) të jenë prezent dhe të ndjekë, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektimit;
- ç) të paraqesin, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesin propozimet e tyre për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse ku i mbështet ato;

2. Detyrimet e subjekteve gjatë procesit të inspektimit:

- a) të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me inspektorin gjatë inspektimit,
- b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit
- c) të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorit, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- ç) të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektori dhe brenda afateve të përcaktuara nga ai;